



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2023:036338

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458778

C.nr.67/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.B. nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson me autorizim K.O. avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor E.Ç., për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit, kompensimin e pagesës shtesë për licencim, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 15.03.2024, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me nr. të referencës së Ndërmjetësimit ND.2015/24 e datës 22.01.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësueses H.O., në mes të paditësit B.B., të cilin e përfaqësoi me autorizim K.O. avokat në Mitrovicë dhe të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim të cilën e përfaqësoi përfaqësuesi ligjor E.Ç., me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit, kompensimin e pagesës shtesë për licencim.

II. Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.2015/24, e datës 22.01.2024, e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të saj ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtave ditore) për prani në punë, në të cilën ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër detyrimit të të paditurës nuk e ka realizuar kompensimin e shpenzimeve për shujta ditore. Tutje ka pohuar se edhe pse i është drejtuar me kërkesë të paditurës për përmbushjen e obligimit, nga e paditura nuk ka marrë përgjigje, andaj ka kërkuar mbrojtje gjyqësore nga gjykata duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit, kompensimin e pagesës shtesë për licencim, të ia paguaj detyrimin dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura me datë 04.01.2024 i ka dorëzuar gjykatës një parashtrësë përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata që këtë çështje juridike kontestimore ta referojë në procedurë të ndërmjetësimit, duke i propozuar gjykatës që për këtë të njoftohen paditësit.

Me datë 20.02.2024 gjykata ka pranuar marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND.2015/24 të dt.22.01.2024.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës ND.2015/24, të datës 22.01.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësueses H.A., në mes të paditësit dhe të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit, kompensimin e pagesës shtesë për licencim, (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës 22.01.2024, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 411 dhe 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore ND.nr.2015/24 e datës 22.01.2024 duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga sa u tha më lartë, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.67/2023 me datë 15.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.